

Njësia akademike: Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gazetarisë

Titulli i kursit (lëndës mësimore): Redaktim në media

Niveli dhe lloji i kursit: Bachelor

Viti i studimeve dhe semestri: III-1

Kodi ose shifra e lëndës: Z

Vlera në kredi ECTS: 4

Koha/lokacioni:

Mësimdhënësi i kursit: Prof. Asst. Dr. Muhamet Jahiri

Detajet kontaktuese:

Qëllimet e kursit (modulit):

Kursi i Redaktimit, synon t'ua mësojë studentëve nocionet themelore të redaktimit në media, median tradicionale si gazeta, radio dhe televizioni, e me theks të veçantë redaktimin në gazetari dhe në internet. Kursi ka për qëllim që studentëve të rinj t'ua krijojë idenë për rrugët, mënyrat dhe fazat e redaktimit në media duke ua mësuar atyre praktikën më të mirë bashkëkohore për redaktimin si një proces të rëndësishëm në prodhimin medial. Mësimet do të jenë të bazuar në standardet e përcaktuara për punën e medias, interesin publik dhe ndikimin që mund të ushtrojë mbi shoqërinë dhe individët e përfshirë në trajtim.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Në fund të kursit, studentët e gazetarisë do të jenë në gjendje që me përkushtim të punojnë për të kryer punë cilësore të mbështetur në standardet më të larta editoriale dhe etike. Ata do të jenë në gjendje të redaktojnë prodhime mediale duke vendosur një drejtpeshim ndërmjet lirisë së shprehjes dhe përgjegjësisë, për të respektuar privatësinë, për të qenë të drejtë e të ndershëm, për të shmangur veprimet e paligjshme dhe për të siguruar mbrojtje të përshtatshme të audiencës nga puna e tyre në media. Në fund të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje të funksionojnë duke ruajtur integritetin editorial dhe pavarësinë nga interesat e jashtme.

Metodologjia e mësimdhënies:

Metodologjia e mësimdhënies është e mbështetur para së gjithash në ligjërata në klasë dhe në ushtrime në klasë. Studentët që ndjekin këtë kurs kanë mundësi të ndjekin edhe ligjërata të gërshtuara me ushtrime, si dhe orë interaktive të diskutimeve për punimet e tyre të pavarura, por edhe kombinimit të punës në bashkëpunim me media vendase e

ndërkombëtare. Studentët marrin pikë vlerësuese që llogariten në ndërtimin e notës përfundimtare përmes detyrave në klasë dhe në shtëpi dhe përmes punës së pavarur në realizimin e shkrimeve. Këshillimet janë pjesë integrale e metodologjisë së mësimdhënies, sidomos në fazat kur studentët përgatisin punimet e tyre.

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	10 min	15	2.5
Kollokfiume,seminare	5	2	10
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja përfundimtare për provim	5	1	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	3	3	6
Projektet,prezentimet ,etj	1	1	1
Totali			161 orë= 7 ECTS

Plani i përgjithësuar:

Java I: Prodhimi medial dhe redaktimi i tij

Java II: Puna e redaktorit para fillimit të redaktimit të prodhimit

Java III: Redaktimi dhe informacioni i nevojshëm për rrethanat shoqërore

Java IV : Redaktimi për gazetën, sfidat profesionale dhe rreziqet e humbjes së audiencës

Java V: Redaktimi për radio

Java VI: Redaktimi pwr televizion

Java VII: Redaktimi pwr uebin

Java VIII: Vlerat editoriale

Java IX: Redaktimi si mision profesional dhe etik

Java X: Redaktimi si mision politik e kombwtar- rasti i Kosovws

Java XI: Redaktimi si operacion manipulues

Java X: Vlerësimi semestral

Java XI: Sfidat e raportimit nw raport me pronarin e mediumit, publikun dhe politikwn

Java XII: Politikat editoriale tw portaleve, raportet e tyre me rrjetet sociale dhe gazetarinw e ngatwrruar

Java XIII: Redaktimi i imazhave

Java IV: Rekapitulim i lëndës.

Metodat e vlerësimit

20 % testi semestral/20% pjesëmarrje dhe angazhim/10% detyra praktike në shtëpi/ 50 % provimi final

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar të respektojnë normat themelore të sjelljes gjatë kohës së ligjëratave dhe ushtrimeve. Gjatë ushtrimeve studentët janë të obliguar të marrin pjesë aktive në mësimet interaktive. Atyre u mundësohet edhe prezantimi individual dhe grupor dhe qasja interaktive në mësim.

Literatura:

- Andreë Boyd, Broadcasted Journalism, Techniques of Radio and Television Neës, Focal Press, Oxford..., 2001, Fifth edition
- REDAKTIMI NË MEDIA (Ligjërata të autorizuar vetëm për studentët e Departamentit të Gazetarisë të UP, nga Prof. Milazim Krasniqi)
- Neil Everton "Përgatitja e lajmit televiziv"
- Gazetaria, Stephan Russ-Mohl,